

**Hapet thirrja për bursa në kuadër të programit Erasmus + për stafin akademik me kohë të plotë të Universitetit të Tiranës në Universitetin Silesian të Teknologjisë, Poloni, për semestrin e dytë të akademik 2022-2023.**

Në kuadër të programit Erasmus + është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për stafin akademik me kohë të plotë të UT-së për mësimdhënie në Universitetin Silesian të Teknologjisë, Poloni, për semestrin e dytë të vitit akademik 2022-2023. Stafi mund të marrë pjesë në aktivitetin “International Staff Week” në datat 12 – 16 Qershor 2023.

<https://www.polsl.pl/EN/Pages/Welcome.aspx>

<https://www.polsl.pl/rn3-1-dwz-swm/en/istw2023/>

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

- Shkëmbimin e stafit akademik për mësimdhënie;

**Kohëzgjatja e bursave:**

- 5 ditë + 2 ditët e udhëtimit;

**Fushat e mësimdhënies:**

- Shkenca kompjuterike;
- Kimi;
- Inxhinieri mjedisi;
- Matematikë e aplikuar;
- Fizikë;

**Bursat përfshijnë:**

- Kompensim ditor (140 EUR për stafin akademik);
- Kostot e udhëtimit (në varësi të distancës midis universitetit pritës dhe atij të origjinës)

<b>DISTANCA E UDHËTIMIT</b> ( <a href="http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm">http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm</a> )	<b>Kompensimi</b>
<b>Midis 100 dhe 499 KM</b>	180 EUR
<b>Midis 500 dhe 1999 KM</b>	275 EUR
<b>Midis 2000 dhe 2999 KM</b>	360 EUR
<b>Midis 3000 dhe 3999 KM</b>	530 EUR
<b>Midis 4000 dhe 7999 KM</b>	820 EUR
<b>8000 KM ose më shumë</b>	1100 EUR

Për të përcaktuar distancën ju lutemi referohuni:

[http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance\\_en.htm](http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm)

## **Dokumentet e nevojshme për aplikim për stafin akademik me kohë të plotë për mësimdhënie:**

- CV+ Lista e publikimeve (në gjuhën angleze);
  - Kopje e Pasaportës;
  - Letër motivimi (në gjuhën angleze);
  - Vërtetim Punësimi (në gjuhën shqipe);
  - Certifikata e gjuhës së huaj (Anglisht B2);
  - Vërtetim nëse keni kryer apo jo më parë një mobilitete Erasmus+ (nëse po, duhet të specifikoni mobilitetet e kryera duke cituar universitetet pritëse dhe periudhën e secilit prej tyre);
  - Letër ftese paraprake;
- <https://www.polsl.pl/rn3-1-dwz-swm/en/faculty-coordinators/>
- Plani i mobilitetit për mësimdhënie\*;

Për të shkarkuar formatin e Planit të Mobilitetit për mësimdhënie klikoni në adresën:

[https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility\\_Agreement\\_Teaching\\_outgoing-1-1.docx](https://unitir.edu.al/wp-content/uploads/2020/09/Mobility_Agreement_Teaching_outgoing-1-1.docx)

\*Plani i Mobilitetit për stafin akademik është një dokument në të cilin duhet të specifikohet programi juaj i propozuar që do të kryeni gjatë periudhës së shkëmbimit. Ky dokument firmoset nga aplikanti dhe nga personi përgjegjës në Rektorat, i cili është Koordinatori Institucional i Erasmus +.

### **Afati për aplikim: 16 Mars 2023**

Dokumentat duhen dorëzuar dorazi në Rektoratin e Universitetit të Tiranës, Sektori i Marrëdhënieve me Jashtë, si dhe duhet të dërgohen të skanuara në e-mailin [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Për më shumë informacion mbi bursat mund të na kontaktoni në adresën: [iro@unitir.edu.al](mailto:iro@unitir.edu.al).

Universiteti i Tiranës ju uron suksese në aplikimin tuaj!